

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### "KYM" SH.P.K.

Sot, në Tiranë, me datë 19.03.2024 me cilësinë e ortakëve themelues të shoqërisë:

- **Charles AKNIN**, shtetas francez, lindur në Jerusalem, me datë 12/01/1963 pajisur me nr.pasaporte 18HF81270
- **Ehsan KHALAILA** shtetas izraelit, lindur në Israel, me datë 31/01/1977 pajisur me nr.pasaporte 33995975
- **Arben MALAJ** shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, me datë 19/09/1961 pajisur me leternjoftim me numer 034211510 dhe numer personal G10919080B

Kane vendosur themelimin e shoqërisë "**KYM**" SH.P.K.

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi të një shoqërie tregtare, nënshkruesi dhe themeluesi i saj merr përsipër të realizojë e të respektojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e shoqërisë:

#### THEMELIMI I SHOQERISE

Në mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" të ndryshuar, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "**KYM**" sh.p.k (më poshtë në këtë akt e quajtur "Shoqëria") nga Ortakët themelues të saj.

## **FORMA E SHOQERISE**

Shoqëria **“KYM” sh.p.k**, më poshtë e referuar si “Shoqëria”, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar krijuar në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë Tregtare”, dhe rregullohet prej këtij ligji, dhe statutit të shoqërisë si dhe prej çdo dispozite tjetër ligjore të aplikueshme.

## **II EMRI I SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA**

### **Neni 1**

#### **Emri**

Emri i shoqërisë është **“KYM” sh.p.k**. Në çdo dokument, faturë, reklamë dhe publikime emri i shoqërisë do të pasohet nga:

- (i) fjala “me përgjegjësi të kufizuar” apo “sh.p.k”
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

### **Neni 2**


#### **Selia**

Selia administrative e shoqërisë do të jetë në: **Tiranë, Rr H.H. Dalli** , kati **Perdhe Godina 8**  
**Kate,**

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë **“KYM” sh.p.k** është **pa afat**. Ortakët kanë të drejtë të kufizojnë këtë afat duke zbatuar procedurat për ndryshimin e Statutit.



### **III OBJEKTI I SHOQERISE**

#### **Neni 4**

#### **Objekti**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar do të jetë:

*Menaxhim projektesh shqiptare dhe te huaja*

Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari që do të konsiderohet nga ortakët si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Shqiptar.

### **IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 3 kuota me një vlerë nominale si më poshtë:

**1. Charles AKNIN**


**1 KUOTE ME VLERE 3400 LEKE OSE SHPREHUR NE PERQINDJE: 34%**

**2. Ehsan KHALAILA**

**1 KUOTE ME VLERE 3300 LEKE OSE SHPREHUR NE PERQINDJE: 33%**

**3. Arben MALAJ**

**1 KUOTE ME VLERE 3300 LEKE OSE SHPREHUR NE PERQINDJE: 33%**

  
Neni 6

## Organizimi

Shoqëria do të drejtohet nga Adminsitratori Znj.Arbana Grizhja . Këtë detyrë do ta kryej për periudhën e parë prej **5 vjetësh**, i cili do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë.

Ortakët autorizojnë administratorin e shoqërisë të bëjë hapjen e shoqërisë në QKB

### ORTAKET E SHOQERISE

• Charles AKNIN

• Ehsan KHALAILA

• Arben MALAJ



Arben MALAJ